



▶ INVESTIMI NË LARMINË E KOSOVËS DHE ZHVILLIMI I TË GJITHA KOMUNITETEVE ..... 1

▶ RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATDHESUAR ..... 2

▶ GARANTIMI I IMPLEMENTIMIT TË PLOTË TË STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTAS ..... 2

▶ ZCK SHPALL LISTËN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE – PËRFITUESE TË FONDIT TË GRANTEVE ... 3



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelaria e Premijera – Office of the Prime Minister  
Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelaria za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

# Fuqia në diversitet

## INVESTIMI NË LARMINË E KOSOVËS DHE ZHVILLIMI I TË GJITHA KOMUNITETEVE

### ZÇK financon ndërtimin e një qendre kulture në fshatin Zebincë

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të investojë në kultivimin e kulturave dhe identiteteve të të gjitha komuniteteve. Larmia kulturore dhe etnike përbëjnë një nga vlerat parësore të Republikës së Kosovës.

Novobërda si një komunë e sapo zgjeruar, kishte mungesë të infrastrukturës kulturore. Shtëpia e Kulturës, e cila gjendet në fshatin Zebincë, do të jetë vendi ku do të organizohen shfaqje të ndryshme, ekspozita dhe ngjarje të tjera kulturore. Kjo do t'i shërbejë komunës së Novobërdës dhe më gjerë, si një vend ku mund të ndahen përvoja dhe ku bëhen këmbime edukative dhe kulturore.



Ndërtesa e Shtëpisë së Kulturës së Novobërdës, me një kosto të përgjithshme prej 90,071 Eurosh, është një projekt bashkëfinancuar nga ZÇK dhe USAID, si pjesë e programit “Nisma për Ndryshime Pozitive” të implementuar nga AED. Ky projekt mbështet përpjekjet e Qeverisë për të zhvilluar aktivitete kulturore me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të identitetit të të gjithë qytetarëve të vendit.

## ZÇK MIRËPRET NJË ANËTAR TË RI TË STAFIT

*Pas një procesi mjaft intensiv të rekrutimit, ZÇK ka kënaqësinë të njoftojë rekrutimin e një Zyrtari të Lartë për Politika*

Me 19 korrik 2010, Znj. Shqipe Hajredini filloi të punojë në ZÇK si Zyrtare e Lartë për Politika.

Me një diplomë Master në fushën e Studimeve Evropiane nga Universiteti i Hamburgut, Znj. Hajredini ka përfunduar një përvojë të ngjeshur profesionale disavjeçare, përfshirë edhe nga Zyra për Mbështetje me Shërbime Juridike brenda ZKM. Si Zyrtare e Lartë për Politika, ajo është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e pozitës së ZÇK në hartimin e legjislacionit si dhe në kryerjen e analizave dhe vlerësimit të politikave dhe krijimit të rekomandimeve. ZÇK e mirëpret Znj. Hajredini në radhët e stafit të vet.

# RI-INTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATDHESUAR: KONSIDERIMI I NEVOJAVE SPECIFIKE TË KOMUNITETEVE

*Zyra për Çështje të Komuniteteve merr pjesë në rishikimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar*

Ri-integrimi afatgjatë i qytetarëve të Kosovës, të cilëve u është mohuar e drejta e qëndrimit në vendet e treta, është një çështje e ndjeshme dhe një proces jashtëzakonisht kompleks, i cili për qëllime të menaxhimit të mirë, kërkon kapacitete institucionale, bashkërendim dhe mjete të konsiderueshme financiare. Për institucionet e reja të Kosovës kjo përbën një sfidë.

Qeveria e Kosovës që nga fillimi i vitit 2010 ka adresuar shqetësimet e shprehura nga shumë medie, organizata joqeveritare e ndërkombëtare, por edhe nga politikanë nga vendet që kthejnë këta persona, duke vënë në pah nevojën për veprime efektive për të garantuar dinjitetin e personave të riatdhesuar.

Një vlerësim i plotë i efikasitetit të mekanizmave ekzistues, që përkujdesen për ri-integrim, u udhëhoq nga Ministria e Punëve të Brendshme me mbështetje nga Zyra për Çështje të Komuniteteve. Si rrjedhojë, Strategjia për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar është rishikuar dhe është emëruar një Bord i ri Ekzekutiv si përgjegjës për bashkërendimin ministror. Tash është radha që Plani i Veprimit – dokumenti i cili përcakton të gjithë hapat praktikë, ndan përgjegjësitë, cakton afatet kohore dhe buxhetin e nevojshëm – të rishikohet.

Riatdhesimi dhe vështirësitë për t'ia filluar nga e para në një vend prej të cilit jemi larguar para shumë vitesh, madje edhe ku mund të mos kemi lindur fare, janë çështje që u përkasin të gjitha komuniteteve, qofshin ato shumicë apo jo. Megjithatë, komunitete të ndryshme përballen me situata të ndryshme kur është fjala për ri-integrim. Komunitetet e ndryshme kanë nevoja të ndryshme. Zyra për Çështje të Komuniteteve, duke ofruar informacione për rishikimin e Planit të Veprimit, do të dëshironte të sigurojë se këto specifika merren në konsideratë dhe përfshihen dhe se ofrohen mundësi të barabarta për ri-integrim për çdo qytetar të Kosovës, pa dallim përkatësie etnike.

## GARANTIMI I IMPLEMENTIMIT TË PLOTË TË STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTAS

### *Takimi i parë i dy mekanizmave bashkërendues*

Me 8 dhe 23 korrik 2010, takimet e para të dy mekanizmave bashkërendues për implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkalinj dhe Egjiptianë – Komisionit Drejtues Ndër-institucional dhe Grupit Punues Teknik për Planin e Veprimit – u mbajtën në Prishtinë.

Zhvillimi i Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë u bazua në pranimin se në Kosovë, si edhe në vendet e tjera evropiane, komunitetet rome, ashkalinje dhe egjiptiane kanë qenë “subjekt i diskriminimit me shekuj” dhe se ato “mbesin [nga] pakicat më të rrezikuara në Evropë.”

Strategjia është një plan gjithëpërfshirës e cila përcakton objektivat në njëmbëdhjetë fusha me qëllim të përmirësimit të kësaj gjendje të patolerueshme. Me qëllim të jetësimit të kësaj Strategjie komplekse është hartuar një Plan i Veprimit, i cili përcakton veprimet, përgjegjësitë, afatet kohore dhe buxhetin e kërkuar nga secili institucion. Me qëllim të bashkërendimit të të gjitha aktiviteteve mes institucioneve të angazhuara, si dhe të kultivimit të bashkëpunimit me palët e tjera të interesit, Plani i Veprimit parasheh edhe themelimin e dy mekanizmave për bashkërendim.

Komisioni Drejtues Ndër-institucional është i ngarkuar të marrë vendime strategjike për të avancuar implementimin e Planit të Veprimit. Nën udhëheqjen e Zëvendëskryeministrit Ramë Manaj, Komisioni Drejtues përbëhet nga përfaqësues nga institucionet e Kosovës, ministritë dhe Këshilli Konsultativ për Komunitete por po ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile nga të tri komunitetet.

Grupi Punues Teknik për Planin e Veprimit, siç tregon edhe emri, është një organ teknik kryesisht i ngarkuar të rishikojë raportet e progresit dhe të formulojë rekomandime, siç janë prioritetet dhe përshtatjet për t'u miratuar nga Komisioni Drejtues. Anëtarësia e tij përfshin edhe përfaqësues nga organizatat e donatorëve.

Takimet e para synonin diskutimet e hollësishme të Kushteve të Përgjithshme (termat e referencës) për të dy organet, të cilat do të garantojnë efikasitetin e plotë të tyre dhe mbledhjen e sugjerimeve nga të gjithë anëtarët. Grupi Punues Teknik po ashtu shqyrtoi raportin e progresit gjashtëmuor nga institucionet. U bënë edhe rekomandimet e para dhe ato do të fillojnë të implementohen menjëherë.

# ZÇK SHPALL LISTËN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE - PËRFITUESE NGA FONDI I GRANTEVE

*Publikimi i përfituesve të grantit pas një vlerësimi të plotë të të gjitha projekteve nga një komision vlerësues*

ZÇK ka kënaqësinë të shpallë listën e organizatave të përzgjedhura nga shoqëria civile nga komisioni vlerësues si përfitues përfundimtarë të programit të ZÇK për Kultivimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve. Këto projekte janë vlerësuar nga partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë bazuar në një varg kriteresh të specifikuar në ftesën për propozime dhe në përputhje me mandatin dhe objektivat e ZÇK.

Organizatave përfituese janë:

- Klubi i gazetarëve D-Press në bashkëpunim me Komunën e Ranillugut
- Shpresëdhënia e jetës
- Qendra për Paqe dhe Tolerancë
- Shoqata e Malazezëve të Kosovës
- Shoqata e Grave LIFE
- Shippl dhe Tides
- Qendra Rinore Shillovë
- Produksioni Link
- Fahri Vraniqi dhe Zbutja e Varfërisë
- Shoqata Artistike Kulturore "Talentet e rinj"
- Shoqata e Vajzave për Monitorim në Kosovë
- Berim
- Prehja
- Barazia

Tri nga këto projekte do të financohen krejtësisht nga OSBE.

OÇA së shpejti do të shpallë edhe listën e komunave të cilave u janë ndarë grante sipas programit për adresim të nevojave të komuniteteve.

## **D-Press dhe Komuna e Ranillugut: Projekti ON AIR**

Pjesëmarrja efektive e qytetarëve në proceset politike dhe vendimmarrje para së gjithash dhe mbi të gjitha kërkon një informim publik cilësor që arrin të informojë numër sa më të madh të popullatës.

Projekti ON AIR, i jetësuar nga D-Press në bashkëpunim me Komunën e Ranillugut synon të afrojë komunën më pranë qytetarëve të saj përmes transmetimeve javore në radio ku kryetari i komunës ose zyrtarë të tjerë i drejtohen popullatës dhe dokumentarëve të emetuar çdo dy muaj mbi jetën dhe preokupimet e banorëve të asaj komune.

Ky projekt do të kontribuojë në këtë mënyrë në forcimin e Komunës së re duke rritur transparencën e punës dhe aktivitetet e veta.

## **Edicioni i dytë i panairit të librit në Graçanicë dhe klubit grafik: Qendra për Paqe dhe Tolerancë**

Pas suksesit të Edicionit 2009, po ashtu të financuar nga ZÇK, Qendra për Paqe dhe Tolerancë do të përsërisë të njëjtën përvojë. Projekti synon të promovojë arsimimin dhe kulturën e komunitetit serb dhe mbajtja e panairit të librit dhe një klubi grafik do të koincidojë me kremtimin e Lartësimin të Virgjreshës Mari, një festë fetare ortodokse.

## **Përmirësimi i vijimit të shkollimit nga pjesëtarët romë, ashkali dhe egjiptianë: projekt për edukimin dhe fuqizimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve i implementuar nga Fahri Vraniqi dhe Zbutja e Varfërisë**

Niveli i ndjekjes së shkollimit nga radhët e fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë është dukshëm më i ulët se i komuniteteve të tjera. Projekti për Edukimin dhe Fuqizimin e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve synon ngritjen e vetëdijes së prindërve dhe fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë për investimet që shkollimi përfaqëson për të ardhmen e tyre.